

**STATUTI**

**SHOQERISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Artemis Consulting” SH.P.K**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 07.01.2023, une themeluesi Andrea Pisani, vendosa te krijoje një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Artemis Consulting” SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

- Andrea Pisani, i datelindjes 21.01.1984, Rajoni nr.3, Lagja Uji i Ftohte, Rruga Murat Terbaci, Ndertesa nr.112, Kati 8, Vlore, mbajtes kartes se identitetit italiane me nr. CA92454EV

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ofrimin e konsulencave IT, programim te softwareve te ndryshem, programim i software te aplikacioneve, konsulence per menaxhimin e ndermarjeve, asistence teknike per kompjutera dhe pajisje te lidhura me ato.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:Rajoni nr.3, Lagja Uji i Ftohte, Rruga Murat Terbaci, Ndertesa nr.112, Kati 8, Vlore

(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nuk ka)

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [artemis.consulting.al@gmail.com](mailto:artemis.consulting.al@gmail.com)

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 35000 (Tridhjetë e pesë mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues "Andrea Pisani": Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 35000 (Tridhjetë e pesë mijë) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### **Neni 9**

##### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Asambleja e përgjithshme mund të vendosë shkarkimin nga detyra para përfundimit të mandatit të administratorit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen para përfundimit të mandatit, me miratim nga asambleja e ortakëve, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Cdo administrator do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve që ligji i ngarkon atij dhe duhet t'ju komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimtaritë e kryera prej tij sa herë që kjo kërkohet nga ortakë.

(4) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

- Andrea Pisani, I datelindjes 21.01.1984 Lagja Uji i Ftohte, Rruga Murat Terbac, Ndertesa nr.112, Kati 8, Vlore, mbajtës kartes se identitetit italiane me nr. CA92454EV

#### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Veprojnë dhe nënshkruajnë në emër të Shoqërisë;
2. Të përpunojnë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe planin e biznesit për vitin financiar, i cili miratohet në mbledhjen e përgjithshme;
3. Merr vendime për kreditë dhe garancitë bankare që do të jepen, me miratimin e asamblesë së përgjithshme;
4. Të përgatisë dhe të paraqesë në miratimin e asamblesë së përgjithshme raportet për veprimtarinë e shoqërisë dhe bilancin përmbyllës të vitit financiar që i referohet vitit paraardhës, sipas afateve të përcaktuara me ligj;
5. Mban në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme;
6. Administratori (ose administratorët nëse më pas emërohet një administrator tjetër) përgjigjet ndaj shoqërisë dhe palëve të treta për shkelje të ligjit ose të statutit që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij/saj, sipas Legjislacionit shqiptar;
7. Kryen të gjitha veprimtaritë e zakonshme të administrimit të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
8. Përfaqëson shoqërinë tregtare;
9. Mbajtja me korrektësi dhe saktësi e dokumentacionit dhe librave kontabël të Kompanisë;
10. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e nevojshme të shoqërisë, sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
11. Kryen detyrat që i ngarkohen me ligj dhe me statut;
12. Raporton në mbledhjen e përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në lidhje me zbatimin e veprimeve specifike me rëndësi të veçantë në veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
13. Rekrutime, paga, largime nga puna, masa disiplinore ndaj punonjësve, miratimi i kërkesave për largim nga vendi i punës, me miratim nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
14. Emërimi i kontabilistëve dhe konsulentëve për problemet e Shoqërisë, me miratim fillestar nga asambleja e përgjithshme e aksionerëve. Kontabilisti raporton rregullisht mbi treguesit financiarë tremujorë, gjashtëmujorë dhe vjetorë për biznesin e Kompanisë;
15. Të menaxhojë kompaninë me drejtësi dhe zell;
16. Të lidhë marrëveshje me palë të treta brenda kufijve të qëllimit afarist të Shoqërisë dhe kompetencave të përcaktuara nga ortakët;
17. Zbatojë rregulloret e brendshme të Kompanisë;
18. Të përgjigjet për dëmet e shkaktuara ndaj shoqërisë nga veprimet e tij;
19. Të paguhet për punën që bën në bazë të marrëveshjes së arritur me anëtarët themelues;
20. Marrë informacion dhe të bëjë propozime për çdo gjë që e gjykon të dobishme për Kompaninë;

21. Kryejë të gjitha aktivitetet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë e Shoqërisë;
22. Administratori ka të drejtë dhe detyrë të thërrasi mbledhjen e përgjithshme, në zbatim dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin. 11 dhe 12 të këtij statuti dhe me ligj kur nuk parashikohet shprehimisht në statut.

## **Neni 15**

### **Pergjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;

- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti financiar-ekspertet**

**Neni 16**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**

**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Kreu V**

**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

##### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **Neni 20**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### ***ORTAKU***

#### ***I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***“Artemis Consulting”SH.P.K***

**ANDREA PISANI**

ANDREA PISANI

